



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2020, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”” (*Komisioni e shqyrton nismën e Këshillit të Ministrave në cilësinë e Komisionit përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Almira Xhembulla, Majlinda Halilaj, Florenc Spaho, Eugen Bojaxhiu, Amra Barova, Koçi Tahiri, Edmond Stojku, Halil Jakimi, Ervis Meço, Roland Xhelilaj dhe Klotilda Bushka.

Të ftuar:

Eliona Kulluri - Përgjegjëse e Departamentit të Punës Sociale dhe Politikës Sociale në Universitetin e Tiranës

Marinela Sota – Përfaqësuese e Universitetit të Tiranës

Izela Tahsini - Përfaqësuese e Universitetit të Tiranës

Elona Dhembo - Përfaqësuese e Universitetit të Tiranës

Erika Bejko - Përfaqësuese e Universitetit të Tiranës

Marsela Allmuça – Përfaqësuese e Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Socialë

Klaudio Pulaha – Përfaqësues i CRCA Albania

Enkeleda Kallciu – Përfaqësuese e Terre des Homes

Albert Nikolla – Zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi, të nderuar deputetë!

Mirëmëngjesi, të nderuar të ftuar!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me këtë rend dite: seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014 “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””. Komisioni e shqyrton nismën e Këshillit të Ministrave në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Përveç deputetëve të komisionit, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, marrin pjesë në mbledhje Eliona Kulluri, përgjegjëse e Departamentit të Punës Sociale dhe Politikës Sociale, Marinela Sota, Izela Tahsini, Elona Dhembo dhe Erika Bejko.

Nga Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë merr pjesë Marsela Allmuça.

Nga CRCA Albania i ftuar është Klaudio Pulaha.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kemi të ftuar zëvendësministrin Albert Nikolla.

Ne kemi përpara të gjitha shtesat dhe rekomandimet e grupeve të interesit. Të pranishme kemi dhe Ardianën, që është relatore e këtij projektligji, si dhe Eglantina Gjermanin nga Nënkomisioni për Barazinë Gjinore.

Pa humbur kohë, e fillojmë me të ftuarit nga Universiteti i Tiranës, me Eliona Kullurin, përgjegjësen e Departamentit të Punës Sociale dhe Politikës Sociale.

Fjala për ju, Elona.

Eliona Kulluri – Faleminderit, zoti kryetar, për ftesën dhe mundësinë që na dhatë për t’u konsultuar për projektligjin për disa ndryshime për Urdhrin e Punonjësve Socialë!

Siç e keni parë, ne ju kemi paraqitur, le të themi, qëndrimin tonë dhe jua kemi dërguar paraprakisht ndryshimet që kemi kërkuar. Ju e dini që u bënë disa vite që është miratuar ky ligj, që më pas pati nevojë për ndryshimet përkatëse. Ndryshimet që kemi kërkuar, sigurisht, edhe miratimin e propozimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ne i kemi paraqitur paraprakisht.

Unë do të theksoj 2-3 ndryshimet më kryesore, sepse, në fakt, nuk janë shumë. Në parim jemi dakord pothuajse me të gjitha ndryshimet që ka propozuar ministria, por, sigurisht, në disa prej tyre ne kemi kërkuar edhe ndryshime të mëtejshme, që urojmë dhe shpresojmë t’i merrni në konsideratë. Një nga ndryshimet më të rëndësishme lidhet me përbërjen e këshillit kombëtar. Është kërkuar që raporti i balancës së anëtarëve të këshillit kombëtar të ndryshojë. Pra, ne

mendojmë se ndryshimi kryesor ka të bëjë me përfaqësimin e ministrive. Janë 15 anëtarë të këshillit, 10 prej të cilëve zgjidhen nga asambleja, përfshirë dhe kryetarin, dhe 5 të tjerët janë përfaqësues nga ministria për çështjet sociale, 1 përfaqësues nga ministritë linjës dhe përfaqësues me rrotacion dhe 2 përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë. Ndryshimi që ne kemi kërkuar është të kemi 2 përfaqësues nga universitetet, duke qenë se, në fakt, ka tri shkolla të punës sociale, pra janë tri universitete publike që ofrojnë formim në punë sociale, si dhe një privat, i cili, po ashtu, ofron një shkollë të punës sociale. Është kërkuar të bëhet zëvendësimi i zëvendëskryetarit të Urdhrit, duke qenë se kryetari është i përfaqësuar dhe zëvendëskryetari nuk është person i zgjedhur, por është personi i emëruar. Neve na bën sens që, në fakt, të ketë një ndarje më të balancuar midis aktorëve. Ky është një nga ndryshimet që kemi kërkuar dhe mendojmë se është i rëndësishëm për t'u aprovuar në versionin tonë.

Ndryshimi tjetër lidhet me nenin 19. Edhe ky ndryshim është mjaft i rëndësishëm dhe ia vlen të ndalem. Kemi të bëjmë me dispozitat kalimtare dhe pretendimi ynë, ajo për të cilën ne ngulim këmbë, është që ndryshimet kalimtare të vendosen të gjitha. Nuk besoj se ka nevojë t'i përmend, sepse jemi dakord me ndryshimet. Sigurisht, ne kemi kërkuar edhe disa ndryshime të reja lidhur me nenin 8, pika 2. Nuk po i lexoj, por ideja është që kur lind e drejta të bëhesh anëtar i urdhrit (dispozitat kalimtare që ne propozojmë, sipas tabelës që ju e keni marrë) është që këto dispozita kalimtare të jenë të përcaktuara në ligj dhe jo në një VKM, siç është kërkuar në fakt nga ministria.

Mendojmë se kjo gjë për ne është e rëndësishme dhe modelet e tjera, edhe Urdhri i Psikologut e ka të përcaktuar në ligj. Ne mendojmë që, nëse do të vihet në VKM, kjo do të vonojë procesin. Ne jemi në një lloj emergjence për miratimin e urdhrit. Procesi i regjistrimit është kryer që 5 vjet përpara, ku ka filluar komisioni i përkohshëm punën dhe qindra punonjës socialë janë në sistem (tashmë punojnë në sistemin arsimor, drejtësi, shëndetësisë) dhe presin të licencohen. Ne theksojmë faktin që urdhri duhet që urgjentisht të shqyrtohet, të kalojnë ndryshimet dhe të fillojnë zbatimin.

Vendosja në ligj e dispozitave kalimtare, që i intereson një masë jo të vogël të punonjësve socialë, që janë tashmë në sistem, sidomos në sistemin publik, është shumë e rëndësishme të kalojë menjëherë dhe të fillojë procesi i miratimit të tyre, i aprovimit të të qenit anëtarë të urdhrit dhe pastaj procesi i licencimit si pasojë.

E theksoj se kjo është edhe në Urdhrit e Psikologut njësoj, kështu nuk gjejmë arsye pse të ndryshohet në rastin e Urdhrit të Punonjësit Social.

Këto janë ndryshimet që ne mendojmë se duhet të qëndrojnë sipas propozimit tonë. Sigurisht që marrin pjesë edhe grupe të tjera interesi, organizata dhe mund të dëgjojmë edhe mendimin e tyre.

Enver Roshi – Faleminderit, Eljona, për diskutimin tuaj shumë racional, shumë konciz dhe shumë profesional!

Ia jap fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë për t’u shprehur.

Zoti Albert.

Albert Nikolla – Përshëndetje të gjithëve!

Po them dy fjalë të përgjithshme për sa u takon këtyre ndryshimeve. Mendoj se kanë ardhur në kohën e duhur, sepse kur rritet shumë kërkesa për një punë sa më profesionale, natyrisht kërkohet edhe që çdo profesion të jetë i përkufizuar mirë. Për këtë arsye mendoj që edhe ndryshimet vijnë në këtë perspektivë.

Ju i patë të gjitha ndryshimet së bashku me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe pikërisht ky është edhe motivi që e shtyu Ministrinë e Shëndetësisë të paraqesë nevojën për këto kërkesa, të cilat i mbështesim.

Një nga kërkesat që mua m’u duk me ngarkesë të fortë ishte ajo që kishte të bënte me personat, të cilët janë tashmë në punë dhe nuk e kanë masterin, që të mos largoheshin nga puna. Pra, t’u jepet një kohë atyre që ta kalojnë edhe ato nivelin e Bachelorit dhe të mos ishin të personave që tashmë ishin për punë. Kjo ishte një ndër pikat më kulmore...

Enver Roshi – Masteri në nivel profesional apo shkencor, jo në nivel baçelori. Jo baçelor, por master profesional dhe shkencor.

Albert Nikolla – Ata që ishin me baçelor mund të ishin në punë, dhe do të kërkojë edhe pjesa tjetër, kjo ishte thelbësore për ne.

Për sa u përket pikave të tjera, ne jemi dakord, i kemi parë të gjitha, dhe kjo na ka shtyrë në këtë kërkesë. Kësisoj, jemi sot këtu për të dëgjuar të gjithë aktorët që janë, të gjithë aktorët e shoqërisë civile dhe ministritë e tjera. në fund, mund të bëjmë një ndërhyrje tjetër.

Faleminderit! shumë.

Enver Roshi – Atëherë, jeni dakord me propozimet e sjella nga fakulteti, nga zonja Eliona Kulluri? Jeni dakord?

Eliona Kulluri – Zoti kryetar, një sekondë! Ajo së cilës ne i qëndrojmë, është varianti i miratuar nga qeveria, e që ka ardhur për miratim në parlament. Sa i takon arsyes se përse i qëndrojmë këtij varianti, është fakti se vetë bllokimi i ngritjes së urdhrit të “Punonjësit social” ka ardhur për shkak të këtyre komenteve që kanë pasur grupe të ndryshme interesi.

E kuptoj shumë mirë dhe e vlerësoj maksimalisht zonjën Kulluri, sepse jo vetëm është një pedagoge shumë e mirë, por dhe një eksperte që ka ndihmuar në shumë nga proceset që kemi ndërmarrë për ndryshime ligjore, veçanërisht në fushën sociale. Prandaj, jemi shumë disponibël që të marrim në konsideratë të gjitha komentet, por sikurse e shpjegova kur u bë miratimi në parim, ky ligj është konsultuar me grupet e interesit, ka qenë dhe insistimi i grupeve të interesit për t'u bërë ky ndryshim. Njëkohësisht, është dakordësuar edhe me Ministrinë e Arsimit, me qëllim rakordimin dhe faktin se ky duhet të jetë në përputhje me ligjin “Për profesionet e rregulluara”.

Sa i takon diferencës që bën “Urdhri i Psikologut” me “Urdhrin e Punonjësit Social”, unë e shpjegova herën e kaluar, besoj dhe mendoj se është e qartë, por në këtë moment ne nuk mund të shprehemi direkt, pa u shprehur edhe Ministria e Arsimit. Në fund të ditës, çështja është: cili nga grupimet? Sepse, natyrisht, zonja Kulluri prezanton këtu vetëm pjesën e atyre që janë për fakultetin, për Universitetin e Shkencave Sociale, por ka edhe grupe të tjera interesi, të cilat nuk përfaqësohen vetëm nga tri organizata apo nga një grup (*ndërprerje incizimi*). Siç e tha edhe zonja Kulluri, që në vitin 2014 janë të regjistruar të gjithë punonjës socialë, në regjistrin që ne kemi, ndaj nuk mund të marrim në konsideratë kërkesën e një grupi që përfaqëson tridhjetë persona, dhe të lëmë jashtë konsiderate komentet dhe kërkesat e grupimit tjetër, i cili përfaqëson më shumë se njëqind punonjës socialë.

Kjo është arsyeja se përse i qëndrojmë kësaj. Është e drejta juaj si komision, që të merrni në konsideratë mendimet dhe komentet e grupeve, por ne i qëndrojmë variantit të miratuar nga qeveria.

Shumë faleminderit!

Enver Roshi – Ju faleminderit!

Unë mendoj se propozimi i sjellë nga universiteti përfaqëson një mendim më filozofik, më akademik, më gjithëpërfshirës, më të arrirë, më të diskutuar nëpër mjedise akademike.

Unë mendoj se thirrja e Ministrisë së Arsimit këtu është paksa e tepërt. Megjithatë, unë ia jap fjalën relatores. Kam edhe profesoreshë Eglantinën këtu, e cila është marrë për një kohë të gjatë me këtë çështje, dhe ka një kontribut të vazhdueshëm në këtë nënkomision, në lidhje me problemet sociale.

Pra, mund të shprehet edhe relatorja. Cili është mendimi juaj, zonja relatore, zonja Ardiana? Edhe një herë, paraprakisht: u jemi drejtuar të gjitha shoqatave, që janë të regjistruara pranë Kryesisë së Kuvendit.

Po.

Ardiana Jaku - Mirëmëngjesi të gjithëve!

Enver Roshi – Më falni!

Disa nga shoqatat kanë kthyer përgjigje dhe ato që kanë kthyer përgjigje janë sot këtu në këtë takim. Të tjerët nuk kanë kthyer përgjigje, por këtu është debati, të vijnë dhe të diskutojnë.

Ardiana Jaku - Zoti Kryetar, mirëmëngjesi!

Përshëndetje të gjithëve!

Uroj të jeni mirë!

Enver Roshi - Po pati mundësi, pa interpretime të gjatë, jeni pro apo jo, dakord?

Ardiana Jaku - Dakord. Unë besoj se kemi nevojë të dëgjojmë edhe pjesën tjetër të organizatave që janë prezente sot këtu në këtë seancë dëgjimore. Besoj se të dëgjuarit do të na bëjë të kuptojmë pak më qartë se çfarë duan të shprehin ato. Është kompetenca jonë si komision të çojmë në Kuvend variantin më të mirë të mundshëm. Kjo na intereson jo vetëm neve, por dhe të gjithë përfaqësuesve dhe shoqatave të interesuara dhe që kanë sjellë komente lidhur me këto ndryshime në projektligj.

Nga ana tjetër në dijeninë time di që dhe Ministria e Arsimit ka dhënë komentet e saj para se projektligji të vinte te ne. Unë do të ulem sërish dhe me drejtoreshën e Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale si institucioni përgjegjës për ta përcjellë këtë ligj, për të vendosur përfundimisht se cilat do të jetë ndryshimet në variantin përfundimtar, para mbledhjes së komisionit, kur do ta shqyrtojmë nen për nen dhe do ta shikojmë më konkretisht. Por këmbëngul të dëgjojmë pak dhe organizatat e tjera, përfaqësuesit e tyre, këndvështrimet e tyre lidhure me këto ndryshime. Theksoj se qëllimi i vetëm është të bëjmë një ligj cilësor dhe që në fund të ditës do t'u shërbejë atyre dhe ata të ndihen të përfaqësuar, të mbrojtur përmes këtij ligji.

Enver Roshi – Dakord e marrim të mirëqenë.

Fjala është për përfaqësuesit e CRCA-së.

Zoti Klaudio Pulaha.

Ju lutem, ndizni mikrofonin!

Klaudio Pulaha – Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë faleminderit për këtë mundësi për njoftimin, ftesën për t'u bërë pjesë e kësaj seance.

Do të doja shumë të falënderoja dhe të përgëzoja për punën e palodhur të të gjithë grupit të punës për sa i përket “Urdhrit të punonjësve socialë”, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, grupin e Departamentit të Punës dhe Politikave Sociale për gjithçka që kanë dhënë në të mirë të këtij urdhri.

Në fakt, jam në të njëjtën linjë edhe si punonjës social me zonjën Kulluri për sa i përket nenit 19, se nëse shikohet qartazi është lënë një hapësirë që të mos penalizohet njeri në momentin që nuk ka një diplomë të nivelit master profesional apo shkencor dhe i është dhënë mundësia si në asnjë urdhër tjetër që në momentin që është në fuqi dhe hyn në fuqi ky ligj personi, profesionist i punonjësit social që do të ketë dëshirën të ushtrojë profesionin, patjetër duhet që më vonë të bëjë këtë master profesional apo shkencor. Ajo që është e rëndësishme, që duhet të vendoset në nenin 19, në dispozitat kalimtare nuk mund të lihet evazive, që mund të bëhet një kurs i specializuar apo specializim, sepse atëherë do të kemi një disbalancë mes masterit profesional, masterit shkencor dhe një kursi profesional që mund të jenë dhe kurset profesionale të drejtoritë rajonale të formimit profesional në të gjithë Shqipërinë, që do të thotë se duhet të specifikohet qartësisht se çfarë do të duhet të ketë për të marrë atë licencë ky profesionist i punës sociale. Të flasim atë që duhet. Për të marrë një licencë duhet të përmbushen disa kritere. “Urdhri i punonjësve socialë” nuk mund të jetë më tolerant sesa ndonjë urdhër tjetër, siç mund të jetë “Urdhri i psikologëve”. Nuk e di se cili është ndryshimi midis “Urdhrit të psikologëve” dhe “Urdhrit të punonjësve socialë”, por kemi të bëjmë me dy profesione, të cilat pretendohet dhe synojmë të rregullohen, që do të thotë se nuk duhet më vonë të lihet hapësirë të “Urdhri i punonjësve socialë”, se nuk mund të lihet hapësirë të një urdhër tjetër.

Kam dhe diçka tjetër për sa i përket një komentit që do të kishim dëshirë të prekej, ishte pjesa e nenit 13, për sa i përket shkronjës “ç”. Ku thuhet të mos kenë marrë masa disiplinore në 5 vjetët e fundit. Mund të qartësohet paksa se nga kush nuk mund të jetë marrë masë disiplinore? Sepse në momentin që nuk jepet masa disiplinore nga Urdhri, për shembull, ai që mund ta ketë tagrin që ta japë, atëherë mundet që të kemi një mundësi edhe abuzimi, sepse mundet që të merret një masë nga një institucion apo nga një organizatë në të mirë ose në të keq të punonjësit social që mund të punojë aty. Kështu që është shumë e rëndësishme që edhe kjo pikë të specifikohet qartazi se nga kush do të merret parasysh pjesa e masës në të cilën është lëshuar.

Këto janë dy komentet, por realisht i mëshojmë shumë faktit të nenit 19 që të tregohemi të kujdesshëm dhe ta vendosim që në ligj. Nuk mund ta lëmë me akte nënligjore këtë pjesë kaq të rëndësishme, por duhet që gjithsecili të kuptojë se në momentin kur do të marrë licencën, duhet të përmbushë kritere që janë të parashikuara të ligji. Unë nuk e di nëse janë punonjësit socialë e regjistruar në vitin 2014 që e kanë dhënë këtë sugjerim, sepse nuk mendoj që një punonjës social që ka mbaruar vetëm nivelin Bachelor do të pretendonte të njëjtën gjë me një punonjës social që mund të ketë mbaruar nivelin master dhe nivelin profesional të masterit, që

do të thotë se është shumë e rëndësishme që në momentin kur nuk e ka bërë për të marrë licencën dhe për të ushtruar profesionin e punës sociale.

Enver Roshi – Faleminderit!

Fjalën e kanë përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë.

Po, Merita. Shtypeni mikrofonin.

Merita Xhafaj – Shumë faleminderit, zoti kryetar!

Ministria e Shëndetësisë, edhe një herë, dua të shprehem, i qëndron variantit që ka ardhur në parlament për t’u miratuar nga qeveria shqiptare.

Qoftë personalisht, qoftë si institucion, ne nuk duam që ky ligj të kalojë, të miratohet dhe të bllokohet procedura për ngritjen e Urdhrit të Punonjësimit Social. Natyrisht, ka diferencë në mënyrën dhe në procedurën e ngritjes së urdhrave, qoftë për profesionet e rregulluara, dhe kjo ka ndodhur edhe për profesionet e tjera të rregulluara, siç është Urdhri i Infermierit, Urdhri i Stomatologut, Urdhri i Psikologut, Urdhri i Punonjësimit Social, por ajo që ka ndodhur është fakti që ligji është i dakordësuar; ishte, në fakt, një ligj i dakordësuar nga të gjithë punonjësimit socialë të regjistruar. Ne kemi pasur problematika për ligjin “Për Urdhrin e Psikologut”, jo për Urdhrin e Punonjësimit Social, dhe në fund, pasi kaloi edhe ligji, u bllokua procedura për ngritjen e Urdhrit vetëm për këto lloj komentesh dhe për ato komente që kanë pasur grupet e interesit.

Në qoftë se u la sot, nuk e di nëse mendimet kanë ardhur nga ata që janë ose jo të regjistruar, natyrisht ne nuk njohim të tjerë dhe regjistri nuk ka pranuar më, sepse ka pasur një *deadline* kur janë pranuar, regjistruar dhe dokumentacioni, dosjet e depozituara në ish-Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe të Rinisë, pasi që atëherë ka filluar kjo procedurë. Është pikërisht ky grupim i atyre punonjësve socialë të regjistruar që e kanë sjellë këtë kërkesë.

Nga ana tjetër, doja të sqaroja edhe faktin pse është përfshirë Ministria e Arsimit. Arsyeja pse është involvuar Ministria e Arsimit nuk është vetëm për shkak të ligjit “Për profesionet e rregulluara”, por edhe për faktin tjetër që procesi i integritimit në Bashkimin Europian kërkoi domosdoshmërinë dhe obligimin e të gjitha institucioneve shqiptare për përshtatjen e legjislacionit shqiptar me atë europian dhe me direktivat e BE-së. Është për këtë arsye që Ministria e Arsimit ka dhënë okejin.

Unë kam këtu mendimet e të tria ministrive: të Ministrisë së Arsimit, të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë, pa të cilat ligji nuk mund të kalonte në Këshillin e Ministrave. Kështu që, mund të ketë detaje, të cilat ne mund t’i qartësojmë me akte nënligjore, si për shembull ... (nuk dëgjohet). Kur flasim për ligjin për ngritjen e Urdhrit të Punonjësimit Social nuk bëhet fjalë për masa disiplinore që merren nga organizatat, por për masa disiplinore

të marra zyrtarisht nga institucionet shtetërore. Në qoftë se ka nevojë për ndonjë qartësim, ne mund ta shtojmë gjatë miratimit nën nën ose me akt nënligjor.

Shumë faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Po, Eliona.

Eliona Kulluri - Unë dua të theksoj dy fakte.

Së pari, është e vërtetë që fillimi i punës për ngritjen e Urdhrit na mori kohë dhe pa e kuptuar kanë kaluar 6 vjet, por, siç e di edhe zonja Merita, që ka qenë pjesë e procesit, ne kemi qenë një grup që kemi përfaqësuar universitetet e ndryshme në këshillin e përkohshëm, por jemi konsultuar vazhdimisht edhe me grupet e interesit dhe organizata.

Për shkak të vonesës që u krijua, sepse versioni i parë kishte probleme edhe në mënyrën si do të bëheshin zgjedhjet për të formuar ligjin, dhe prandaj u kthye, në 6 vjet ne u përpoqëm të bënim edhe ndryshimet që tani propozohet të jenë të reflektuara në projektligj. Është rasti që ne të mos i kthehem më, por t'i bëjmë njëherë e mirë këto ndryshime. Gjithashtu, kohë na mori edhe kalimi nëpër ministrinë e linjës, si ajo e Drejtësisë, Arsimit e të tjera.

Jo për t'u justifikuar, por ky ka qenë një proces i gjatë dhe ligji është konsultuar me shumë organizata. Ne kemi zhvilluar aktivitete akademike dhe konferenca për ta konsultuar ngritjen e Urdhrit dhe besoj se Klaudio dhe të tjerë aktorë të ftuar sot e dëshmojnë këtë gjë. Në fakt, unë nuk përfaqësoj këtu veten time dhe as vetëm departamentin, por të gjitha universitetet që ofrojnë formimin në punë sociale dhe organizatat që kanë bashkëpunuar me ne, që kryesisht kanë qenë organizata me shumë eksperiencë, me profesionistë si Klaudio, por edhe organizata që përfaqëson apo edhe të tjera që unë i shikoj këtu, si *Terre des Hommes*, si edhe organizata ndërkombëtare me të cilat ne kemi bashkëpunuar në të gjitha këto vite. Mendoj që propozimet tona reflektojnë opinionin e shumicës së këtyre aktorëve. Pra, nuk është thjesht një pretendim yni.

Enver Roshi – Faleminderit!

Fjalën e ka Enkelejda Kallçiu, përfaqësuese e *Terre des Hommes*.

Enkelejda Kallçiu – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Ajo që dua të theksoj, dhe besoj se të gjithë bien dakord, është që ky projektligj sjell ndryshime shumë pozitive, që të gjitha palët i kanë dëshiruar dhe i shikojnë të reflektuara. Po ashtu, mendoj që të gjitha palët bien dakord që ky proces të mbyllet dhe Urdhri i profesionit të Punonjësit Social të vihet në praktikë. Ky është elementi më i rëndësishëm që unë doja të theksoja.

Po ashtu, për faktin që vënia në praktikë e Urdhrit ka qenë e shumëpritur, do të ishim dakord që rregullimi i kualifikimit dhe licencimit të profesionit të jetë i rregulluar në ligj dhe jo me një VKM më pas. Kjo do të kursente kohë dhe qartësitë që do të duheshin më pas në rrugë e sipër. Pra, mendoj që nëse kjo gjë rregullohet në ligj, dhe një pjesë e propozimeve janë dërguar edhe me shkrim, përbën avantazh për mënyrën se si do të ecë procesi në vijim. Në këtë drejtim do të donim të mbështesnim faktin që kualifikimi i informimit të punonjësve socialë të rregullohet në nivelin e ligjit. Për mua pesha kryesor është të vijojë të vihet në jetë ky projektligj, por, mbi të gjitha, urdhri i profesionit.

Enver Roshi - Faleminderit!

A kanë komente përfaqësuesit e ministrisë?

Merita Xhafaj - Jo, nuk kemi komente.

Shumë faleminderit!

Enver Roshi - Faleminderit ju!

Po, zonja Marsela Allmuça.

Marsela Allmuça - Përshëndetje, zoti kryetar!

Unë nuk dua të përsëris kolegët e mi, sepse biem dakord me nevojën që në nenin 19 të jenë të përcaktuara kualifikimi personal dhe sesi do të veprohet me ata persona që nuk kanë një diplomë në punët sociale të nivelit bazë apo master apo ata persona, të cilët nuk e kanë fare një kualifikim në punët sociale, por ndërkohë ushtrojnë profesionin e punonjësit social.

Unë mendoj se është e rëndësishme që një nga qëllimet e këtij projektligji është rritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve. Besoj se zonja Xhafaj më jep të drejtë që ne nuk mund të kemi një zbatim të mirë të ligjit të vitit 2016 për shërbimet shoqërore apo të strategjisë kombëtare për mbrojtjen sociale, nëse nuk kemi profesionistët e duhur.

Zoti kryetar, jemi në një moment ku punonjësit socialë i kemi me qindra, prandaj them që urdhri duhet të sanksionojë edhe mënyrën sesi do të garantohet cilësia, në mënyrë që të kemi në treg profesionistët që janë vërtet me kualifikimin e duhur dhe aftësitë e duhura për të zbatuar një profesion të tillë.

Unë mendoj se është momenti që, përveçse të çojmë përpara këtë proces të miratimit dhe krijimit të urdhrit, por edhe të përqipemi të garantojmë cilësinë e ofrimit të shërbimeve nga këta profesionistë.

Lidhur me propozimin e dhënë nga ministria, te dispozitat kalimtare, neni 19, i cili thotë që punonjësit, të cilët nuk kanë një kualifikim në punët sociale, por kanë një kualifikim të cunguar, diplomë bachelor ose master, domethënë, jo të dyja, t'u jepet e drejta për një periudhë të caktuar kohe për ndjekjen e një kualifikimi të tillë. Unë mendoj që nuk mund të qëndrojmë

evazivë, por duhet të jemi specifike ose konkrete, ashtu sikurse në propozimet që janë sjellë nga departamenti i punës dhe politikave sociale, të cilët janë konsultuar me ne, si grupe interesi, ku është shumë e qartë që, nëse një person ka një diplomë bachelor në punët sociale dhe, ndërkohë, ka minimumi 3 vjet eksperiencë, i jepet e drejta të ndjekë një kualifikim, të japë provimin e shtetit dhe të marrë licencën e punonjësit socialë. Kjo është edhe për ata individë, që, në fakt, eksperiencia e përditshme na ka treguar, besoj se zonja Xhafaj dhe zonja Jaku, të cilat kanë qenë pjesë e sistemit të shërbimeve sociale, e dinë se ka profesionistë shumë të mirë, të cilët nuk kanë një diplomë bazë në punë sociale, por kanë pasur një master profesional dhe janë profesionistë shumë të mirë. Unë mendoj se duhet sanksionuar.

Unë do të doja shumë që sugjerimet e sjella në komision të merren në konsideratë, sepse është një mënyrë që të garantohet cilësia e profesionistëve. Mendoj se nuk është momenti që të jemi evazivë dhe të themi: “Kurse të formimit profesional në përgjithësi”, apo të themi: “Një periudhë e caktuar kohe”, por gjërat të sanksionohen dhe të jetë një mënyrë për të garantuar cilësinë.

Zoti kryetar, mendoj se periudha e pandemisë, përveç aspekteve shëndetësore, nxori nevojën për të pasur profesionistë shumë të mirë në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale. Nëse nuk kemi profesionistët e duhur, them që është diskutim i kotë fakti sesa efektivë mund të jemi në situata të tilla, por jo vetëm.

Shumë faleminderit për mundësinë!

Shpresoj që propozimet tona të merren në konsideratë.

Enver Roshi - Ju falënderoj të gjithëve për komentet që dhatë lidhur me projektligjin!

Natyrisht, ju i keni dërguar edhe në formë të shkruar, por edhe seanca e sotme dëgjimore e pasuroi më shumë diskutimin për komentet për projektligjin dhe, kur t’i kalojmë nen për nen në mbledhjen e ardhshme, do t’i marrim parasysh, duke pasur, njëkohësisht, edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë në diskutim.

Ju falënderoj!

Izela Tahsini- Dua të ritheksoj çështjen e nenit 19 për dispozitat kalimtare. Është e rëndësishme të themi se ajo që sugjeron departamenti është vendosur para 2 vjetësh në një takim me 50 përfaqësues të të gjitha institucioneve publike dhe OJF-ve, i organizuar nga vetë ministria. Madje kemi qenë të gjithë së bashku: Marsela, Klaudio, zonja Merita, zonja Denada dhe kemi rakorduar bashkë që këto dispozita të lehtësojnë punonjësit që nuk e kanë diplomën. E vetmja gjë që ne po kërkojmë tani është që kjo të mos shtyhet me VKM, por të ndodhë tani. Pra, është një gjë e rënë dakord, është i tejkaluar si bashkëveprim dhe si diskutim.

Enver Roshi – Do të diskutohet nen për nen dhe do të merret parasysh çfarë do të futet në diskutim. Madje në këtë aspekt, për këta që nuk kanë kryer profilin e punonjësit social, por janë tashmë në struktura shtetërore u jepet e drejta që jo me kushte, por me kualifikim universitar.

Elona Kulluri – Që janë të legjitimuara.

Enver Roshi - Urdhëroni, zonja Merita!

Merita Xhafaj – Unë e vlerësoj maksimalisht dhe dua të mbështeten të gjitha komentet, por për të gjithë ata që kanë ardhur të përfaqësojnë grupet e interesit kam një pyetje: a keni qenë të përfshirë në momentin e hartimit të ligjit të parë? Po. A keni qenë ju që keni hartuar dhe keni bllokuar edhe procedurën e ngritjes së këtij urdhri? Po. Jam shumë dakord që t'i marrim në konsideratë, por ne duhet të bëjmë një analizë: çfarë na lehtëson në procesin e ngritjes së urdhrit dhe çfarë do të na pengojë në procesin e ngritjes së urdhrit?

Është shumë kollaj të merren në konsideratë komentet tuaja, sidomos për nenin 19, për tranzicionin, por këtu janë të shprehura komentet tuaja, jo komentet tona, sepse ne e kemi miratuar ligjin dhe kemi qenë të gatshëm të ngremë urdhrin, në qoftë se doni vërtet. Në fakt, është në interesin tuaj, sepse yni është që të kemi vërtet profesionistë të fushës për t'i trajtuar të gjitha çështjet sociale, në mënyrë të veçantë ato që kanë të bëjnë me ata persona në nevojë për shërbimet sociale. Nga ana tjetër, më shumë se sa interesi ynë, është në interesin tuaj që ky urdhrë të ngrihet. Prandaj, do të kërkoja mirëkuptimin tuaj, që sa më pak bëjmë ndryshime dhe sa më pak barriera të ketë në procedurën e ngritjes së këtij urdhri, aq më shumë do të jetë në interesin e të dyja palëve dhe në interes të zbatimit të këtij ligji. Kjo ka qenë arsyeja që është bllokuar, pra këta do të jenë anëtarë të urdhrit apo strukturat drejtuese të urdhrit, si do të jenë kriteret e përzgjedhjes. Ju lutem, për këtë pikë, për sa kohë keni qenë ju që i keni hartuar dhe i keni marrë në konsideratë të gjitha komentet, të kemi një dakordësi edhe ne me ju.

Faleminderit!

Enver Roshi - Faleminderit!

Elona Kulluri – Zoti kryetar, edhe një sqarim të vogël.

E gjithë kjo vonesë nuk ka ndodhur se ne nuk kemi dashur, përkundrazi ne kemi qenë shumë nxitës për të gjithë procesin bashkë me ministrinë, sepse pa diskutim e kemi bërë bashkë këtë proces. Ajo që ndodhi është se versioni që erdhi në fund në Kuvend pamë që ishte i ndryshëm nga ai që kishte rënë dakord i gjithë grupi që është marrë me formimin e ligjit. Prandaj, ne jemi akoma këtu sot dhe nuk duam të bëjmë përsëri gabime që të na sjellin vonesa të tjera. Asgjë te neni 19 nuk pengon fillimin e punës së urdhrit. Nuk është asnjë pengesë aty,

thjesht janë përcaktuar gjërat ashtu siç duhet, mendojmë ne, në mënyrë që të mos kemi më vonesa. Ideja është: gabimet që u bënë më përpara të mos përsëriten më.

Enver Roshi - Faleminderit të gjithëve!

Faleminderit deputetëve dhe të ftuarve!

Ditën e hënë në orën 10:00 Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë do të mbledhet për ta kaluar nen për nen projektligjin.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA